



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Përqendrimi

Rasti: Messer Belgium N.V. dhe Messer Romania Gaz S.r.l. / Buse Gaz S.r.l

Autoriteti i Konkurrencës, në datë 22.12.2017 me shkresën Nr 530 Prot, ka marrë njoftimin mbi transaksionin e realizuar me anë të “Marrëveshjes për transferimin e kuotave” nga përfaqësuesi i autorizuar i palës blerëse.

Me anë të kësaj marrëveshje, të nënshkruar me datë 24 nëntor 2017, synohet të realizohet transferimi i kuotave të ndërmarrjes Buse Gaz S.r.l. (“Target”) tek Messer Belgium N.V. në mënyrë të drejtpërdrejte dhe të tërthortë nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar tërësisht prej saj Messer Romania S.r.l. (Blerësi).

Ky njoftim bëhet për shkak se Blerësi plotëson kriteret e xhirove në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- Messer Group. Messer Belgium N.V. dhe Messer Romania Gaz S.r.l. janë pjesë e Messer Group, një grup ndërkombëtar shoqërisë aktive në mbarë botën në prodhimin dhe shpërndarjen e gazeve industriale, mjekësore dhe të veçanta si dhe shërbimet e lidhura me këto produkte. Messer Group është aktiv në shumë shtete të botës. Në Shqipëri, Messer Group është i pranishëm nëpërmjet shoqërisë shqiptare të kontrolluar tërësisht prej tij, Messe Albagaz SHPK.
- Buse Gaz S.r.l. zotërohet 100% nga shoqëria gjermane Buse KSW GmbH & Co. KG (Shitësi). Buse Gaz S.r.l është një shoqëri rumune aktiviteti i së cilës konsiston në prodhimin, përpunimin, procesimin, paketimin, shitjen dhe shpërndarjen e gazeve industriale si dhe shitjen dhe shpërndarjen e gazeve të veçanta brenda territorit të Rumanisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.